



Energjia e ripërtëritshme në Maqedoni
Prodhimi i energjisë elektrike të “pastër”

Analitika
- Dhjetor 2008 -

www.analyticamk.org

Në kohëra kur shtetet e UE-së investojnë shuma të mëdha për rritjen e pjesëmarrjes së burimeve ripërtëritëse energjetike (BRE) në prodhimin e përgjithshëm energjetik, me ç'rast bëhen liderë botëror në prodhimin e energjisë së "pastër" elektrike, Maqedonia dhe vendet tjera të Evropës Juglindore (EJL), janë ende të varrura nga importimi i energjisë elektrike, duke u ballafaquar me mungesë dhe probleme enorme të vazhdueshme në furnizimin me energji elektrike. Sistemi energjetik i Maqedonisë në bilansin energjetik përfundimtar karakterizohet me intenzivitet të lartë energjetik, efikasitet të ulët dhe mungesë të burimeve vetanake të ripërtëritshme për energji elektrike. Mungesa e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE si dhe mungesa e qëllimeve për prodhim të ennergjisë nga burime ripërtëritëse edhe më shumë e përkeqësojnë gjendjen e pavolitshme të sektorit energjetik në vend.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të ofrojë disa rekomandime për promovim sa më të madh të BRE në tregun energjetik të Maqedonisë. Duke i dhënë një analizë të gjerë rolit dhe vendit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në tregun energjetik, ky raport jep rekomandime për promovim sa më të madh të burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e të ashtuquajturës energji elektrike të "pastër" në Maqedoni.

I. Në pjesën e parë shqyrtohen arsyet për futjen e BRE në prodhimin e energjisë elektrike në Maqedoni. Kështu, zhvillimi i një tregu energjetik stabil, implementimi i legjislacionit të UE-së dhe zvogëlimi i emisioneve të CO₂ janë identifikuar si tre arsye kryesore për futjen e BRE në prodhimin e energjisë elektrike në Maqedoni.

II. Pjesa e dytë analizon tregun e energjisë së ripërtëritshme në Maqedoni, nivelin e zhvillimit dhe pengesat, me fokus të veçantë në prodhimin e energjisë elektrike. Pjesëmarrja e BRE në furnizimin e përgjithshëm të ennergjisë elektrike në Maqedoni është shumë e ulët. Burimi i tillë më i përdorur është ai hidropotencial, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike nga era konsiderohet të jetë ende në fazë hulumtimi. BRE-të tjera në Maqedoni (gjeotermale, solare dhe biomasa), tradicionalisht përdoren për nxemje, por me efikasitet të ulët energjetik, me çka këto burime ende nuk merren parasysh për prodhim të energjisë elektrike. Në formë institucionale, tregu energjetik në Maqedoni rregullohet me Ligjin për energjetikë të vitit 2006, me ndryshimet më të reja të vitit 2008. Përveç këtij ligji, nën presion politik të UE-së, qeveria gjatë dy viteve të kaluara solli akte të shumta nënligjore që nevojiten për implementimin e legjislacionit të UE-së, që kanë të bëjnë me prodhimin e energjisë elektrike nga BRE. Paralelisht me këtë proces u vendosën tarifata e garantuara për energji elektrike të prodhuar nga hidroenergji, era, sistemet fotovoltaike dhe biomasa. Përveç reformave në legjislacion u bë edhe konsolidimi dhe restrukturuimi i aktorëve kryesorë të tregut energjetik në Maqedoni siç janë Ministria e ekonomisë, Agjensionin për energjetikë dhe Komisionin regulator për energjetikë. Përkundër fillimeve modeste të tregut për energji ripërtëritëse në Maqedoni, raporti identifikoi më shumë pengesa për zhvillimin e mëtutjeshëm të tregut të qëndrueshëm të energjetikës. Në pjesën e legjislacionit mungon Strategjia kombëtare për energjetikë si dhe Strategjia e detajuar për zhvillim të burimeve ripërtëritëse të energjisë. Ekzistojnë shumë barrierat administrative në implementimin e projekteve me energji ripërtëritëse, probleme me byrokratinë dhe politizim të vendimeve. Veç kësaj, struktura dhe madhësia e tregut ennergjetik në Maqedoni janë pengesa serioze për zhvillimin e prodhimit masiv të energjisë elektrike nga burime ripërtëritëse. Ekzistojnë edhe probleme teknike për prodhim dhe transport të energjisë elektrike nga BRE, probleme lidhur me shpenzimet e

larta kapitale për ndërtimin e kapaciteteve për shfrytëzim të burimeve ripërtëritëse të energjisë, si dhe probleme me financimin e projekteve për energji ripërtëritëse.

III. Pjesa e fundit e tekstit jep rekomandime për integrim të shpejtë të BRE në tregun e energjisë elektrike në Maqedoni. Rekomandimet kanë të bëjnë si me ofertën ashtu edhe me kërkesën e energjisë elektrike.

- Në pjesën e ofertës së energjisë elektrike sjellja e Startegjisë kombëtare për energjetikë është e patjetërsueshme. Ky dokument do të nënkuptonte strategjinë gjithëpërfshirëse për sektorin energjetik në Maqedoni ku do të përfshiheshin edhe BRE-të. Përveç kësaj strategjie të përgjithshme, për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik në vend nevojitet përpilim urgjent i strategjisë së dytë e cila do të merreshte ekskluzivisht me BRE-të. Kjo strategji duhet të japë analizë të detajuar rreth kapacitetit dhe potencialit të BRE-ve ndërsa strategjia konkrete duhet të përpunojë konceptin e prodhimit të energjisë elektrike të BRE-ve. Strategjia e BRE-ve gjithashtu duhet të caktojë qëllimet e energjisë së prodhuar në nivel kombëtar. Si rekomandim i tretë në anën e ofertës për funksionim më efikas të tregut të energjetikës në Maqedoni, raporti e thekson domethënien e kornizës efektive ligjore. Për sigurimin e investimeve në energjitë e ripërtëritshme nevojitet kornizë ligjore funksionale, posaçërisht në pjesën e cila ka të bëjë me implementimin e direktivës evropiane 2001/77 për prodhim të energjisë elektrike nga BRE. Rekomandimet tjera kanë të bëjnë me nevojën e përforsimit të kapaciteteteve të institucioneve që zbatojnë politikat për energji ripërtëritëse në Maqedoni. Nevojitet eliminim i barrierave byrokratike përmes zbatimit të trajnimeve dhe transfer të diturive për administratë publike më efikase. Për gjithë këto reforma në pjesën e BRE, nevojitet zhvillim i rritjes të burimeve stabile të financimit të projekteve përmes kredive, subvencioneve shtetërore, fondeve regjionale dhe ndërkombëtare. Të lartpërmendurat duhet të shkojnë paralelisht me investimet e vazhdueshme në projekte arsimore dhe hulumtuese, që do të çonin drejt qëndrueshmërisë dhe konkurrencës së pilot projekteve në tregun evropian.

- Në anën e kërkesës, duhet të rritet shpenzimi i përgjithshëm energjetik në vend për rritjen e prodhimit të enenergjisë nga BRE. Me rritje reale ekonomike dhe hapje të tërërsishme të tregut enenergjetik, vendi do të bëhet më atraktiv për investimet e huaja. Përveç kësaj për fillimin e projekteve për energji të ripërtëritshme, për qëndrueshmërinë dhe profitabilitetin e tyre duhet që çmimi i energjisë elektrike të arrijë deri në një nivel rentabil dhe të rregulluar përmes tregut. Çmimi më i lartë i enenergjisë elektrike do të çonte drejt futjes në përdorim të BRE, si burim më i lirë për prodhim të energjisë elektrike.

Paralelisht me masat institucionale dhe financiare, ngritja e vetëdijes publike është pjesa më e rëndësishme për ekspansionin e energjisë ripërtëritëse. Sipas kësaj, Agjensioni për Energjetikë duhet të zhvillojë strategji të veçantë për promovim të gjerë të BRE, si dhe kampanja të ndryshme për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për beneficinet e prodhimit të energjisë nga burimet ripërtëritëse.

Energji dhe infrastrukturë

Publikimet e mëparshme:

"Gazpërçuesit dhe sfidat rajonale:
Vlerësimi i rolit të Maqedonisë në tregun e gazit në Evropën Juglindore"

"Gazi natyror – nevojë energjetike për Maqedoninë
Pasqyrë mbi potencialin energjetik të Maqedonisë"

Kontakt

ANALITIKA

Dame Gruev 7/8-3
1000 Skopje, Macedonia
tel: + 389 2 312 1948
web: www.analyticamk.org
info@analyticamk.org

Hulumtues në Programin për energji dhe infrastrukturë:

Natasha Hroneska
nhroneska@analyticamk.org

Analitika - organizate e pavarur joprotabile e perkushtuar per te ndihmuar persona dhe institucione ne perforcimin dhe permiresimin afatgjate te demokracise dhe udheheqjes si ne R. e Maqedonise ashtu edhe me gjere ne rajon.

Analitika eshte organizate per analize dha hulumtim te politikave publike (think-tank), e perkushtuar ne promovimin dhe zhvillimin e bashkpunimit ndermjet subjekteve dhe organizatave ne R. e Maqedonise dhe me gjere.